

# Preportr

## Deficiti i profesorëve



Kolegjet private kanë mungesë të theksuar të stafit akademik.

Në mungesë të stafit këto kolegje po mundohen t'i mbulojnë nevojat e tyre me profesorë që vijnë nga rajoni dhe më gjerë.

Agjencia e Akreditimit të Kosovës, ka kërkuar nga këto kolegje që të krijojnë stafin e tyre, pasi veç kështu do të mund t'i shpëtojnë programet nga mos akreditimi. Preportr në këtë hulumtim ka parë lidhjet politike të menaxhmentit të këtyre kolegjeve dhe sa prej profesorëve punojnë edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë. Ekspertët e arsimit vlerësojnë se kolegjet duhet të kenë kuadër të përgatitur për fusha të caktuara, në mënyrë që mos të kenë probleme gjatë akreditimit të programeve

## Besa Kalaja

Në Kosovë ka mungesë të theksuar të stafit për nevoja të arsimit të lartë. Duke marrë parasysh numrin e lartë të institucioneve të arsimit të lartë, kuadri duket të jetë problemi më i madh. Kriteret e Agjencisë për Akreditim, kanë avancuar në kërkim të një kuadri më cilësor dhe adekuat për akreditimin e një programi. Megjithatë në terren nuk është vërejtur shtim i madh i kuadrit arsimor, atij me kualifikim superior gjë që ka bërë që kuadri aktual të kalojë nga një universitet, përkatësisht kolegji në tjetrin.

Mungesën e kuadrit Preportr, e ka trajtuar edhe te universitetet publike kurse një gjë e tillë e cila do të trajtohet në këtë hulumtim është problem i madh edhe i kolegjeve private.

Duke e parë mungesën e stafit në vend disa prej personave përgjegjës të kolegjeve i kanë thënë Preportr, se po mundohen të krijojnë stafin e tyre, kurse si alternativë thonë se po gjejnë profesorë në rajon dhe më gjerë për të mbuluar mungesat.

Preportr përveç mungesës së stafit në këtë hulumtim ka parë edhe lidhjet politike si dhe në sa vende punon

stafi i disa prej kolegjeve private. Të dhënat tregojnë se ka një numër të madh të profesorëve të kolegjeve private që punojnë edhe në universitetet publike e sidomos në Universitetin e Prishtinës që në këtë rast po ashtu nuk arrin të mbulojë kërkesat e veta me staf të rregullt.


Është shikuar edhe për profesorët që vijnë nga jashtë shtetit, se a janë të rregullt edhe në universitetet e tyre edhe në Kosovë por nuk është gjetur ndonjë të dhënë për një gjë të tillë. Kujtojmë se kjo ka qenë një problem i madh në të kaluarën dhe Agjencia e Akreditimit të Kosovës, pati filluar t'i identifikojë ata.

Njohësit e fushës së arsimit mungesën e stafit e shohin si problemin më të madh edhe për faktin e numrit të madh të studentëve që frekuentojnë universitetet publike dhe kolegjet private.

Udhëheqësit e kolegjeve private ndërkaq e shohin si problem të madh akreditimin, i cili ka vënë rregull sidomos të puna e stafit, edhe pse Agjencia e Akreditimit të Kosovës, pas akreditimit në asnjë rast nuk monitoron kolegjet për të parë që stafi i paraqitur për akreditim të programeve është duke dhënë mësim në ato kolegje.

“Në këtë mënyrë do t’i eliminojmë deklaratimet e dyfishta dhe vendet e dyfishta të punës, që në të kaluarën ka pasur”

## Gazmend Luboteni, AKA



### Kolegjet me mungesë stafi

Mungesa e stafit është problem shumë i madh për kolegjet. Shumë programe të këtyre kolegjeve nuk janë akredituar në mungesë të këtij stafi.

Kolegjet po i mbulojnë nevojat e tyre duke angazhuar staf edhe nga jashtë Kosovës, më së shumti nga vendet e rajonit. Kërkesa e AKA-së për këto raste është që mësimdhënësit e angazhuar nga vendet e tjera mos të jenë profesorë të rregullt në universitetet në vendet e tyre. Preportr ka shikuar të gjithë emrat që janë vendosur në ueb-faqet e kolegjeve për të parë nëse ndonjëri prej tyre është i punësuar si profesor i rregullt në ndonjërin prej universitetet e vendeve prej nga vijnë, por nuk ka gjetur ndonjë rast të tillë. Ndërsa ka të tillë që vijnë nga vendet tjera dhe që punojnë si të angazhuar në kolegje.

AKA në mandatin e kaluar kishte filluar t’i identifikojë profesorët që mbanin nga dy punë si profesorë të rregullt këtu në Kosovë dhe në vendet e rajonit. Puna e tyre ishte ndërprerë pasi Qeveria e Kosovës mori vendim për shkarkimin e bordit të këtij institucioni.

Përbërja e tashme e bordit, këtë çështje e ka adresuar në nivel të ministrive të arsimit në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut dhe thonë se kanë marrë zotime që në rast se një profesor deklarohet nga kolegjet e Kosovës si i rregullt, ndërsa në të njëjtën kohë është në marrëdhënie të rregullt pune në këto vende ofrohen të dhëna për ta nga këto shtete.

“Në këtë mënyrë do t’i eliminojmë deklaratimet e dyfishta dhe vendet e dyfishta të punës, që në të kaluarën ka pasur”, thotë Gazmend Luboteni Kryetari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)

“Vetëm sa për statistikë deri në vitin 1999, vetëm 5.6% e popullatës së Kosovës kanë pasur të përfunduar fakultetin, pas vitit 1999 me hapjen e tregut edhe normal me qasjen në arsimin e lartë ky numër është rritur por prapë është i vogël ”

## Uran Rraci, Universum

Edhe brenda Kosovës sipas tij, kjo tashmë është rregulluar ligjërisht, duke shmangur kështu praktikën e mëhershme kur profesorët kanë mundur të punojnë si të rregullt në dy e më shumë institucione të arsimit të lartë.

Bekim Marmullaku, shef i zyrës për sigurimin e cilësisë në kolegjin Fama, thotë se tanimë nuk ka lëvizje të mëdha të stafit nga njëri universitet në tjetrin. Kjo në njëfarë mënyre paraqet problem të madh pasi në Kosovë ka mungesë të madhe të stafit akademik.

“Kosova ka mungesë shumë të madhe të profesorëve universitarë edhe në raport me kuotën numri i studentëve me një profesor sipas standardeve të Bashkimit Evropian është i vogël, edhe në raport me programet sidomos për disa programe deficitare nuk ka staf të mjaftueshëm”, thotë ai.

Uran Rraci nga kolegji Universum, thotë se përgjatë viteve nuk është investuar shumë në krijimin e stafit, për këtë arsye sot ka mungesë të madhe me staf.

“Vetëm sa për statistikë deri në vitin 1999, vetëm 5.6% e popullatës së Kosovës kanë pasur të përfunduar fakultetin, pas vitit 1999 me hapjen e tregut edhe normal me qasjen në arsimin e lartë ky numër është rritur por prapë është i vogël. Imagjinoni sa ka qenë numri i atyre me master ose me nivelin e doktoratës”, thotë ai.

Nisur nga këto statistika sipas tij, kjo është sfidë, për shkak se nuk ka kuadro të mjaftueshme për t'i përmbyshur kërkesat të cilat janë në institucionet publike edhe në institucione private.




## Kolegjet përpiqen të krijojnë stafin e tyre

Megjithëse stafi është problem i madh për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, në kolegje thonë se po mundohen të krijojnë stafin e tyre. Duket se kjo nuk po realizohet me hapa të shpejtë, pasi në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, thonë se nuk e kanë vërejtur që kjo punë po merret seriozisht nga kolegjet private.

“Ne kemi vërejtur se kolegjet nuk investojnë në stafin e tyre. Ata një nga prioritetet duhet ta kenë që të kenë staf të tyre, të mos bazohen në stafin e jashtëm, qoftë nga UP-ja apo nga vendet e rajonit. Nëse ata investojnë në staf, kjo do të ndikojë edhe në cilësi”, thotë Luboteni.

Ndërkaq zyrtarë nga kolegjet thonë se duke e parë rrezikun që shumë programe në këto kolegje nuk do të akreditohen në mungesë të stafit kanë filluar të krijojnë stafin e tyre. Ata thonë se po u japin bursa studentëve të tyre që të kryejnë studime të doktoratës jashtë shtetit, kur dihet se vet kolegjet nuk mund të ofrojnë këtë nivel të shkollimit dhe Universiteti i Prishtinës ofron një numër të vogël doktoratash për të mbuluar të gjitha nevojat e universiteteve publike dhe kolegjeve private.

“Patjetër, ne veç kemi disa, mjaftueshëm ndoshta,



ish-studentë të kolegjit Fama që sot janë mësimdhënës në Fama, dhe vazhdimisht përpiqemi që me kriteret që i kemi të definuara me rekrutu staf së pari brenda studentëve që i kemi në nivelet bachelor dhe master, domethënë prapë ka mjaftueshëm këtu”, thotë Marmullaku nga kolegji Fama.

Sidoqoftë sfida më e madhe sipas tij është mungesa e programeve të doktoratës brenda Kosovës. Marmullaku thotë se në mungesë të programeve të doktoratës brenda Kosovës, studentët po detyrohen të doktorojnë jashtë dhe në universitete të dyshimta.

“Për fat të keq ato diploma edhe po nostrifikohen këtu, ata njerëz po bëhen profesorë, po më duhet me thënë që Agjencia e Akreditimit vetëm letër po lyp, e dikush letër po ju dërgon, që nuk po përputhet me qëllimin e përbashkët që kemi ne dhe ata e që është ngritja e cilësisë”, thotë ai.

Uran Rraci nga kolegji Universum thotë se ata kanë filluar të investojnë në staf të menaxhmentit të mesëm apo junior.

“Këtë po e bëjmë duke ua financuar pjesërisht studimet ose duke u mundësuar fleksibilitet që edhe të përfundojnë studimet e doktoratës por edhe të punojnë për kolegjin Universum në mënyrë që ata nesër të bëhen pjesë

“Ne kemi vërejtur se kolegjet nuk investojnë në stafin e tyre. Ata një nga prioritetet duhet ta kenë që të kenë staf të tyre, të mos bazohen në stafin e jashtëm, qoftë nga UP-ja apo nga vendet e rajonit. Nëse ata investojnë në staf, kjo do të ndikojë edhe në cilësi”

**Gazmend Luboteni,**  
**AKA**

e stafit të rregullt me doktoratë”, thotë ai.

E veç që nuk mund të plotësojnë nevojën e tyre me staf është edhe një problem tjetër me të cilin përballen kolegjet. Atyre nuk u njihen avancimet akademike të stafit akademik.

“Kjo do me thënë se stafin tënd nuk ke të drejtë ta avancosh sepse në momentin që ti nuk mund ta avancosh ose nuk mund të ofrosh studimet e doktoratës një institucion jashtë teje bëhet më atraktiv për atë që dëshiron të ndjek zhvillimin e tij personal”, thotë Shemsedin Vehapi zv.rektor në kolegjin AAB

Në këtë rast sipas tij njerëzit orientohen drejt atyre institucioneve që i avancojnë ata, e në këtë rast penalizohen kolegjet.

### **Profesorët politikanë dhe me nga dy vende pune**

Në mungesë të stafit shumica e profesorëve në Kosovë japin mësim në disa universitete publike, por edhe në kolegje private, e po ashtu ata janë të angazhuar në jetën politike e publike duke mbajtur edhe pozita të rëndësishme, si ministra, zv. ministra, këshilltarë politikë etj. Duke u nisur prej këtij fakti, Preportr, ka shikuar të gjitha ueb-faqet e kolegjeve private dhe i ka marrë të gjitha listat me profesorë që kanë qenë të publikuara aty për të parë lidhjet politike të pronarëve, rektorëve dhe stafit me partitë politike.

Preportr ka gjetur se 39 mësimdhënës që janë të angazhuar në kolegjet private në të njëjtën kohë janë të angazhuar edhe në universitetet publike të Kosovës

### Stafi akademik i cili është i angazhuar edhe në Universitetet publike edhe në ato private

| Të dhënat nga insitucionet arsimore private |                      |           | Të dhënat nga insitucionet arsimore publike |                    |                           |
|---------------------------------------------|----------------------|-----------|---------------------------------------------|--------------------|---------------------------|
| Emri                                        | Pozita               | Kolegji   | Pozita                                      | Forma e angazhimit | Universiteti publik       |
| Besnik Krasniqi                             | Profesor             | Globus    | Profesor                                    | I asocuar          | Universiteti i Prishtinës |
| Esat Derguti                                | Profesor             | Globus    | Profesor                                    |                    | Universiteti i Mitrovicës |
| Sahit Surdulli                              | Profesor             | Globus    | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Mitrovicës |
| Regjep Gjergji                              | Profesor             | UBT       | Profesor                                    |                    | Universiteti i Prishtinës |
| Salem Lepaja                                | Profesor             | UBT       | Profesor                                    |                    | Universiteti i Prishtinës |
| Muzafer Shala                               | Ligjerues            | Universum | Prof.asistent                               |                    | Universiteti i Mitrovicës |
| Berat Ujkani                                | Ligjerues            | Universum | Asistent                                    |                    | Universiteti i Mitrovicës |
| Fitor Ollomani                              | Ligjerues            | ISPE      | Prof.asistent                               |                    | Universiteti i Gjakovës   |
| Ajet Ahmeti                                 | Profesor             | Dardania  | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës |
| Haki Demolli                                | Profesor             | Dardania  | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës |
| Xhevat Berisha                              | Profesor             | Biznesi   | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës |
| Artan Nimani                                | Prof.asistent        | Biznesi   | Prof.asistent                               |                    | Universiteti i Gjakovës   |
| Armand Krasniqi                             | Profesor me angazhim | Biznesi   | Profesor                                    | i rregullt         | Universiteti i Prishtinës |
| Muhamet Qerimi                              | Profesor             | Biznesi   | Prof.asistent                               |                    | Universiteti i Prishtinës |
| Baki Koleci                                 | Profesor             | Biznesi   | Prof.asistent                               |                    | Universiteti Haxhi Zeka   |
| Kole Krasniqi                               | Profesor             | Biznesi   | Profesor                                    | I asocuar          | Universiteti Haxhi Zeka   |
| Vehbi Ramaj                                 | Profesor             | Biznesi   | Profesor                                    | asistent           | Universiteti Haxhi Zeka   |
| Halim Bajraktari                            | Prof.asistent        | Biznesi   | Profesor                                    | asistent           | Universiteti Ukshin Hoti  |

## Stafi akademik i cili është i angazhuar edhe në Universitetet publike edhe në ato private

| Të dhënat nga insitucionet arsimore private |                        |         | Të dhënat nga insitucionet arsimore publike |                    |                                  |
|---------------------------------------------|------------------------|---------|---------------------------------------------|--------------------|----------------------------------|
| Emri                                        | Pozita                 | Kolegji | Pozita                                      | Forma e angazhimit | Universiteti publik              |
| Agnesa Çanta                                | Ligjeruese e angazhuar | Biznesi | Asistente                                   |                    | Universiteti i Prishtinës        |
| Adhurim Rasimi                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | asistent           | Universiteti i Prishtinës        |
| Adem Rusinovci                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës        |
| Hajrush Fazliu                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I asocuar          | Universiteti i Prishtinës        |
| Zake Prelvukaj                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës        |
| Valbona Petrovci                            | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës        |
| Flamur Mrasori                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | asistent           | Universiteti i Prishtinës        |
| Illir Gjinolli                              | Ligjërues              | AAB     | Asistent                                    | I angazhuar        | Universiteti i Prishtinës        |
| Abdulla Aliu                                | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | në pension         | Universiteti i Prishtinës        |
| Arsim Bajrami                               | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës        |
| Asllan Bilalli                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | ne pension         | Universiteti i Prishtinës        |
| Bedri Bahtiri                               | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | asistent           | Universiteti i Prishtinës        |
| Kyvette Shatri                              | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | asistent           | Universiteti i Prishtinës        |
| Rahman Paçarizi                             | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I asocuar          | Universiteti i Prishtinës        |
| Nazim Myrtaj                                | Ligjërues              | AAB     | Profesor                                    | I angazhuar        | Universiteti i Prishtinës        |
| Shkelzen Shala                              | Ligjërues              | AAB     | Asistent                                    | I angazhuar        | Universiteti i Prishtinës        |
| Arbnore Kepuska                             | Ligjërues              | AAB     | Asistent                                    | /                  | Universiteti i Prishtinës        |
| Avni Rudaku                                 | Profesor               | AAB     | Asistent                                    | I angazhuar        | Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan |
| Ibrahim Rudhani                             | Profesor               | AAB     | Profesor                                    | I asocuar          | Universiteti i Prishtinës        |
| Shpend Elezi                                | /                      | AAB     | Profesor                                    | I rregullt         | Universiteti i Prishtinës        |
| Merita Hashani Bacaj                        | Ligjeruese e angazhuar | AAB     | Asistent                                    |                    | Universiteti i Prishtinës        |

### Stafi akademik i cili është i angazhuar edhe në Universitetet publike edhe në ato private

| Të dhënat nga insitucionet arsimore private |           |         | Të dhënat nga insitucionet arsimore publike |                    |                                                               |
|---------------------------------------------|-----------|---------|---------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------|
| Emri                                        | Pozita    | Kolegji | Pozita                                      | Forma e angazhimit | Universiteti publik                                           |
| Mirvan Xhemaili                             | Ligjerues | AAB     |                                             |                    | Profesor i rregullt ne South East European University, Tetova |
| Qatip Arifi                                 | Ligjerues | AAB     |                                             |                    | Profesor part time në South East European University, Tetova  |
| Mentor Hamiti                               | ligjerues | AAB     |                                             |                    | Profesor i asocuar ne South East European University, Tetova  |
| Shevqet Zekolli                             | Ligjerues | AAB     |                                             |                    | Profesor ne Universitetin e Tetovës                           |

Po ashtu është shikuar se në sa vende pune punojnë profesorët që gjenden në këto ueb-faqe. Duhet theksuar se të dhënat që gjenden në ueb-faqet e universiteteve publike dhe kolegjeve private, nuk përditësohen, kështu që mund të ketë profesorë që mund të kenë lëvizur- larguar nga universitetet publike po edhe nga ato private. Në listat e provimeve disa prej tyre kanë qenë të angazhuar në vitin akademik 2018-2019, por nuk dihet nëse kanë vazhduar edhe përgjatë këtij viti akademik.

Edhe ky hulumtim si edhe hulumtimet e tjera të kësaj natyre që i ka bërë Preportr, na tregojnë se profesorët

që punojnë në Universitetin e Prishtinës, punojnë ose janë bashkëpunëtorë edhe të kolegjeve private. Po ashtu ka raste që profesorë të UP-së që kanë dalë në pension tanimë japin mësim pa asnjë problem në kolegje private.

Preportr ka shikuar lidhjet politike të stafit menaxhues që punojnë në kolegjet private dhe kanë lidhje me partitë politike. Nga të dhënat e nxjerra rezulton se 15 prej tyre kanë lidhje me politiken: gjashtë nga LDK, pesë PDK, një VV dhe dy nga AAK.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se 39 ligjërues kanë marrëdhënie pune me kolegje private dhe ato publike

Në mungesë të stafit shumica e **profesorëve** në Kosovë japin mësim në disa **universitete publike**, por edhe në **kolegje private**, e po ashtu ata janë të angazhuar në jetën **politike e publike** duke mbajtur edhe pozita të rëndësishme, si **ministra, zv. ministra, këshilltarë politikë etj.** Duke u nisur prej këtij fakti, Preportr, ka shikuar të gjitha ueb-faqet e kolegjeve private dhe i ka marrë të gjitha listat me **profesorë** që kanë qenë të publikuara aty për të **parë lidhjet politike të pronarëve, rektorëve dhe stafit me partitë politike.**



## Anëtarët e subjekteve politike të cilët janë të angazhuar në Kolegjet Private

| Kolegji            | Emri                                       | Lidhja me politiken | Partia     | Pershkrimi i lidhjes me politiken                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|--------------------|--------------------------------------------|---------------------|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Akademia Evolucion | Gani Mehmetaj                              | Anëtar              | LDK        | Njëri nga themeluesit e LDK-së. Ka qenë i afërt me LDK-në. Gani Mehmetaj deri ne vitin 2017 ka deklaruar që punon në këtë institucion                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Kolegji Arbëri     | Fatbardha Emini                            | Anëtare             | LDK        | Anëtare e LDK-së, drejtoreshë e Arsimit në komunën e Vitisë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Kolegji Biznesi    | Bislim Zyrap                               | Këshilltar politik  | PDK        | Bislim Zyrap është këshilltar politik i presidentit Hashim Thaçi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| "Kolegji Dardania" | Avdullah Hoti, Haki Demolli                | Deputet             | LDK        | Bislim Zyrap është këshilltar politik i presidentit Hashim Thaçi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Kolegji ESLG       | Dhurata Hoxha                              | Ministre            | PDK        | Dhurata Hoxha ish- ministre nga PDK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Kolegji FAMA       | Besim Beqaj                                | Minister            | PDK        | Besim Beqaj ish-minister nga PDK ne vitin 2010 ka deklaruar qe punon ne kolegjin FAMA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Kolegji Iliria     | Memli Krasniqi                             | Deputet             | PDK        | Memli Krasniqi deputet i PDK-së ka deklaruar në vitin 2016 që është ligjerues në këtë kolegji                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Kolegji ISPE       | 1. Burim Ramadani,<br>2. Nuredin Ibishi    | Deputet             | AAK<br>LDK | Në listen e stafit akademik te ISPE janë dy ish deputetët e AAK dhe LDK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Kolegji Juridica   | 1. Sala Berisha Shala,<br>2. Afrim Selimaj | Deputet/<br>Anëtar  | PDK<br>AAK | 1. Sala Berisha Shala ne vitin 2017 ka deklaruar qe punon si ligjeruese ne Juridica, e njejta eshte deputete per disa mandate nga PDK. 2. Afrim Selimaj eshte prorektor ne Universitetin e Pejes, i njejt ka qenë kandidat për Këshilltar Komunal në zgjedhjet lokale të vitit 2009. Me 2015 është zgjedhur anëtar i kryesisë së AAK-së, dega në Pejë. Në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 ka marrë pjesë në aktivitetet elektorale të AAK-së |
| Kolegji UBT        | Vjosa Hamiti                               | Këshilltar politik  | VV         | Vjosa Hamiti keshilltare komunale ne KK Prishtine nga VV, ka deklaruar ne vitin 2018 qe eshte prodekane ne UBT                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Kolegji Universi   | Bahri Blakçori                             | Këshilltar politik  | LDK        | Bahri Blakçori ka deklaruar ne vitin 2017 qe është ligjerues në këtë kolegji                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Kolegji Universum  | Fiknete Bejta                              | Këshilltar politik  | AAK<br>LDK | Fiknete Bejta keshilltare komunale nga AAK ( <a href="https://kk.rks-gov.net/prishtine/staff/fiknete-bejta/">https://kk.rks-gov.net/prishtine/staff/fiknete-bejta/</a> ), gjithashtu ne formulare te deklarimit ka deklaruar qe eshte zyrtare per media ne LDK                                                                                                                                                                                 |

## Pronarët dhe drejtuesit e kolegjeve private që kanë lidhje me subjektet politike

| Kolegji            | Pronarët                                                                                                                                                                                                                   | Rektoret/Drejtuesit e Programeve               | Lidhja me politiken | Partia                                                                              | Pershkrimi i lidhjes me politiken                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Koment                   |
|--------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|---------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| "Kolegji Dardania" | Ismet Gashi, Halim Gjergjizi                                                                                                                                                                                               |                                                | Donator Donator     |    | Ismet Gashi ka dhënë donacion në kontribute në mallra dhe shërbime për LDK-në, në vitin 2012 në vlerë 1,800 euro (donacioni është dhënë si qira e zyreve. Gjithashtu gjatë viteve 2013-2015 LDK në vlerën e njëjtë dhe arsyen e njëjtë ka deklaruar të hyra nga një person me emrin e Ismet Gashi, i cili mundet me qenë pronari i Kolegjit Dardania | Halim Gjergjizi, drejtor |
| Kolegji ESLG       | Visar Hoxha, Institut za ustavno ureditev in clovekove pravice d.o.o.                                                                                                                                                      |                                                | Tjetër              |    | Visar Hoxha është bashkëshorti i Dhurata Hoxhës, ministre nga PDK                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                          |
| Kolegji Juridica   | Teuta Beka, Agnesa Beka                                                                                                                                                                                                    | Vesel LATIFI - dekan, Flamur Maloku - prodekan | Anëtar              |  | Flamur Maloku prodekan në Kolegjin Juridica, u anëtarësua dhe më vonë u largua nga VV                                                                                                                                                                                                                                                                |                          |
| Kolegji Riinvest   | Rasim Mrlaku, Arian Shala, Valton Bilalli, Gent Beqiri, Driton Stavovci, Artane Rizvanolli, Fadil Aliu, Lumir Abdixhiku, Nysret Musliu, Idriz Smaili, Hazir Gashi, Alban Hashani, Yll Haxhimusa, Lutfi Zharku, Lule Ahmedi |                                                | Deputet             |  | Lumir Abdixhiku dhe Lutfi Zharku janë aksionar në Riinvest, të dy janë deputet të LDK-së                                                                                                                                                                                                                                                             |                          |

apo ka raste kur një profesor jep mësim në dy kolegje private. Preportr ka gjetur se në katër raste profesorë që punojnë në universitetet e Maqedonisë së Veriut, japin mësim edhe në kolegjet private në Kosovë. Megjithatë nuk kanë marrëdhënie të rregullt pune në të dy institucionet, të dhënat tregojnë se në mungesë të profesorëve, ata lëvizin nga njëri institucion në tjetrin.

Shumica e ligjëruesve që punojnë edhe në universitetet publike edhe në ato private janë të kolegjit AAB, kolegji më i madh në Kosovë. 20 prej atyre që janë

kontrolluar punojnë në këtë kolegji dhe në universitetet publike. I dyti për nga numri i madh i atyre që punojnë edhe në publik edhe në privat është kolegji Biznesi me gjithsej 9, UBT me 2, në Globus 3, Universum 2, ISPE një, Dardania 2.

Të dhënat për ligjëruesit që punojnë janë marrë në ueb-faqet e këtyre kolegjeve. Shumica e kolegjeve i kanë publike listat e profesorëve, por të disa prej tyre figuron një numër shumë i vogël i tyre.



## Mungesa e stafit problem i madh

Ekspertë të arsimit vlerësojnë se mungesa e stafit në kolegjet private është aq i madh sa edhe cilësia e këtij stafi. Dukagjin Pupovci ekspert i arsimit duke folur për kuadrin në kolegjet private por edhe ato publike të arsimit të lartë, thotë se stafi akademik është boshti kurrizor dhe identiteti i secilit institucion të arsimit të lartë, si dhe faktori kyç që përcakton reputacionin e institucionit. Asnjë program i studimeve sipas tij nuk mund të akreditohet as të mbahet pa një numër minimal të stafit akademik të kualifikuar dhe kjo është e keqja më e vogël që mund të ndodhë.

“Nëse nuk ka staf të kualifikuar programi i studimeve nuk duhet të ekzistojë dhe kjo vlen si për sektorin privat, ashtu edhe atë publik. Edhe ashtu, kemi mjaft programe të studimeve që janë të ngjashme me njëritjetrin. Për fat të keq, gjatë procesit të akreditimit stafi akademik shihet vetëm si numër, pa u lëshuar në analiza më të hollësishme të kualifikimeve profesionale, përveç atyre formale”, thotë ai.

Pupovci identifikon një numër faktorësh pse niveli i arsimit të lartë ka mungesa të stafit. Kjo vjen sipas

tij sepse Kosova ka një numër shumë të madh të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, prandaj sigurimi i stafit akademik të kualifikuar paraqet një sfidë.

Sa i përket shtimit të numrit të programeve të doktoratës, ai mendon se ato nuk mund të shtohen përderisa nuk ka forma të organizuara të punës kërkimore-shkencore, siç është rasti me Universitetin e Prishtinës.

“Përkundrazi, duhet të insistohet që për secilin program të doktoratës të ekzistojë të paktën një program kërkimor në nivelin institucional, ku doktorantët e ardhshëm do të mund t’i bëjnë hulumtimet e tyre, e jo t’i financojnë nga xhepi i tyre pa asnjë mbikëqyrje të profesorëve”, thotë ai.

Me siguri se Kosovës i nevojiten më shumë doktorë të shkencave, jo vetëm për t’i mbajtur universitetet e kolegjet, por edhe në segmente të tjera të sektorit publik dhe privat, por kjo sipas Pupovcit nuk do të thotë se tani duhet të hapen programe të doktoratës aty ku nuk ka kushte elementare për të prodhuar cilësi.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, Kosova ka pasur rreth 1,400 doktorë të shkencave, gjë që as për së afërmi, nuk

## Mungesa e stafit problem i madh

“Nëse nuk ka staf të kualifikuar programi i studimeve nuk duhet të ekzistojë dhe kjo vlen si për sektorin privat, ashtu edhe atë publik. Edhe ashtu, kemi mjaft programe të studimeve që janë të ngjashme me njëri-tjetrin. Për fat të keq, gjatë procesit të akreditimit stafi akademik shihet vetëm si numër, pa u lëshuar në analiza më të hollësishme të kualifikimeve profesionale, përveç atyre formale”

**Dukagjin Pupovci**

i plotëson nevojat për staf të arsimit të lartë po edhe të institucioneve të tjera publike dhe private. Në ndërkohë disa prej tyre mund të kenë dalë në pension, por edhe janë shtuar

“Vitin tjetër do ta kuptojmë nga regjistrimi sa ka arrihur ky numër – ka gjasa të jetë dyfishuar, pasi janë shtuar mundësitë për përfundimin e studimeve të doktoratës, ndonjëherë edhe si rezultat i uljes së kriterit. Me këtë dua të them se numrat nuk sjellin medoemos edhe cilësi”, thotë Pupovci.

Këtu sipas tij, ka rol Agjencia e Akreditimit e cila nuk duhet të mjaftohet vetëm me sigurimin e numrit minimal të stafit akademik të kualifikuar për çdo program, por duhet të vlerësojë edhe cilësinë e stafit. Kjo do të ishte një garanci për cilësinë e ofertës së arsimit të lartë në Kosovë.

Në anën tjetër kolegjet sipas tij nuk bëjnë përpjekje për të krijuar stafin e tyre sepse ato funksionojnë si biznese dhe e marrin të gatshëm stafin tanimë të kualifikuar.

“Kolegjet në Kosovë janë biznese dhe synojnë të punësojnë staf tanimë të kualifikuar, ndërsa opsioni më pak i preferuar është mbështetja e stafit të ri për të mbarruar studimet e doktoratës”, shton ai.

Disa prej këtyre kolegjeve sipas tij kanë zgjedhur të sjellin staf nga vendet tjera të rajonit dhe kjo është në rregull përderisa ata njerëz janë të kualifikuar dhe i përkushtohen punës së re. Megjithatë sipas Pupovcit, ka pasur raste kur janë sjellë njerëz, të cilët, faktikisht, vazhdojnë të punojnë në vendet e veta, ndërsa këtu ju figuron emri vetëm sa për ta kaluar procesin e akreditimit.

“Kjo paraqet mashtrim dhe nuk duhet të tolerohet”, vazhdon ai.

**SHËNIM:** ORGANIZATA ÇOHU ËSHTË ANËTARE E KOALICIONIT PËR INTEGRITET DHE TRANSPARENÇË NË UNIVERSITET – KITU, MBËSHTETUR NGA FONDACIONI I KOSOVËS PËR SHOQËRI TË HAPUR – KFOS

KY HULUMTIM ËSHTË PJESË E PROGRAMIT TE KITU-SË. PIKËPAMJET E SHPREHURA NË KËTË HULUMTIM JANË TË ORGANIZATËS ÇOHU! DHE NUK PARAQESIN MEDOEMOS PIKËPAMJET E FONDACIONIT TË KOSOVËS PËR SHOQËRI TE HAPUR – KFOS.